



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**

**PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT PËR NDRYSHIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 16, QARKU DIBËR, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 26.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të zaz-së nr. 16, Qarku Dibër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.279 datë 10.05.2019, ka miratuar caktimin e VNV së KZAZ nr.16 në Pallatin e Sportit "Ferit Hysa" Burrel, me sipërfaqe mbi 200 m2, Bashkia Mat.

Bashkia Mat, me shkresat nr. 1599 prot., datë 14.06.2019, nr. 1599/2, datë 20.06.2019, drejtuar KZAZ nr. 16, për dijeni KQZ, Prefektit të Qarkut Dibër, ka kërkuar lirimin e menjëhershëm të ambjenteve që janë në administrim të saj, të cilat janë përcaktuar për tu vënë në dispozicion të KZAZ nr. 16 për zgjedhjet e datës 30.06.2019.



**Nr.875 i Vendimit    Data 26.06.2019 e Vendimit    Ora 11:00 e Vendimit**

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të zaz-së nr. 16, Qarku Dibër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019

Prefekti i Qarkut Dibër, në vlerësim situatës dhe bazuar në ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", me shkresën nr.12328 prot., datë 26.06.2019, propozon ndryshimin e vendndodhjes së VNV-së së ZAZ nr.16 duke e caktuar në Palestrën e Shkollës së Mesme " Pjetër Budi" Burrel, me sipërfaqe 425 m2.

Ambienti i propozuar ndodhet brenda territorit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, dhe kriteret e Udhëzimit nr. 4, datë 9.04.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për mënyrën e caktimit dhe organizmit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, për caktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit".

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

### **V E N D O S I**

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 16, Bashkia Mat, në Shkollën e Mesme " Pjetër Budi" Burrel, palestra me sipërfaqe 425m2,.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr.875 i Vendimit    Data 26.06.2019 e Vendimit    Ora 11:00 e Vendimit**

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të zaz-së nr. 16, Qarku Dibër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019